



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ROSKOVEC
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 4035 Prot.

Roskovec, më 02, 06 2021

VENDIM
NR 37 .DATË 31 .05 .2021

“PËR FILLIMIN E PROCESIT GJYQËSOR PËR ANULLIMIN E AKTEVE ADMINISTRATIVE AMTP MIRATUAR ME VKB NR. 21, DATË 25.07.2013 DHE VKB NR.12, DATË 21.05.2014”.

Mbështetur në Ligjin Nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, i ndryshuar, neni 54, gërma h; Kodit të Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë, neni 113; Vendimit të Këshillit të Bashkisë Roskovec Nr.21 datë 25.07.2013 dhe Vendimit të Këshillit të Bashkisë Roskovec Nr.12 datë 21.05.2014 “Për Miratimin e listës së përdoruesve faktik të tokës bujqësore dhe subjekteve përfitues që plotësojnë kushtet ligjore për t’u pajisur me AMTP, vendndodhjen e tokës, sipërfaqen dhe kufitarët për çdo ngastër” si edhe në shkresën nr. 2843/2 Prot, datë 14.05.2021 të Prokurorisë së posacme kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar, Tiranë, Këshilli i Bashkisë,

VENDOSI:

- 1- Fillimin e procesit gjyqësor për anulimin e akteve administrative, Akteve të Marrjes së Tokës në Pronësi (AMTP) miratuar me: Vendimin e Këshillit të Bashkisë Roskovec Nr. 21, datë 25.07.2013 dhe Vendimin e Këshillit të Bashkisë Roskovec Nr.12 datë 21.05.2014 “Për Miratimin e listës së përdoruesve faktik të tokës bujqësore dhe subjekteve përfitues që plotësojnë kushtet ligjore për t’u pajisur me AMTP, vendndodhjen e tokës, sipërfaqen dhe kufitarët për çdo ngastër”, pasi vijnë në kundërshtim me dispozitat e ligjit Nr. 57/2012 dhe Nr. 171/2014.
- 2- Ngarkohet Drejtoria Juirdike dhe Burimeve Njerezore për zbatimin e këtij vendimi.
- 3- Pjesë përbërëse e këtij vendimi është tabela me të dhënat e akteve administrative AMTP miratuar me VKB Nr. 21, Datë 25.07.2013 dhe VKB Nr.12, Datë 21.05.2014.
- 4- Ky vendim hyn në fuqi 10 (dhjetë) ditë pas shpalljes.

